

L I G J
Nr.8551, datë 18.11.1999

PËR AVOKATURËN E SHTETIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përfaqësimi dhe mbrojtja në gjyq e shtetit

1. Avokatura e Shtetit është person juridik dhe përfaqëson e mbron Republikën e Shqipërisë:
 - a) në çështjet gjyqësore, ku një organ qendror ose vendor i administratës publike është palë, kundrejt një personi privat;
 - b) në çështjet gjyqësore, ku Republika e Shqipërisë është palë, kundrejt shteteve të tjera;
 - c) në çështjet gjyqësore, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë para një gjykate ndërkombëtare, me përjashtim të Gjykatës së Strasburgut.
2. Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron në gjyq interesat pasurore të shtetit për investimet e tij në subjektet publike ose private.
3. Avokatura e Shtetit ushtron përfaqësimin dhe mbrojtjen në gjyq pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit.
4. Avokatura e Shtetit mund të ngarkojë organin e interesuar për të bërë mbrojtjen në shkallë të parë.
5. Avokatura e Shtetit, bashkërendon punën me Prokurorinë për mbrojtjen në gjyq të shtetit për ato çështje, ku zgjidhja e çështjes civile bëhet gjatë procesit penal.
6. Avokatura e shtetit për çështje që kërkojnë specializim dhe që janë të rëndësishme së veçantë mund të pajtojë për përfaqësim e mbrojtje avokatë të lirë, sipas këtij ligji dhe Rregullores së Avokaturës së Shtetit.

Neni 2

Këshillimi

1. Avokatura e Shtetit në mbrojtje të të drejtave dhe të interesave të shtetit jep këshilla ligjore me kërkesën e organeve të administratës publike dhe në veçanti për të vënë në lëvizje, për të kundërshtuar ose për të tërhequr çështje për gjykim.
2. Kur i kërkohet, Avokatura e Shtetit jep paraprakisht mendim për projektet e kontratave të organeve të administratës publike, enteve publike dhe subjekteve ku shteti është pronar i vetëm ose bashkëpronar, si dhe mund t'u përgatisë këtyre, kontrata të rëndësishme.
3. Avokatura e Shtetit bën sugjerime rreth procedimeve administrative me natyrë konfliktuale, të cilat mund të bëhet shkas për lindjen e konflikteve gjyqësore.
4. Avokatura e Shtetit jep mendim, me kërkesë të Kryeministrit, për projektaktet që lidhen me veprimtarinë e organeve të administratës publike.
5. Asnjë organ i administratës publike apo ent publik nuk mund të kërkojë ndihmë juridike nga avokatë në profesion të lirë, me përjashtim të rasteve të veçanta, sipas rregullave që do të vendosen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3
Ndërmjetësimi dhe pajtimi

1. Avokatura e Shtetit me kërkesë të Kryeministrit, zgjidh me ndërmjetësim mosmarrëveshjet midis organeve qendrore të administratës publike dhe enteve publike.

2. Avokatura e Shtetit rekomandon zgjidhje me pajtim për mosmarrëveshjet midis organeve qendrore dhe atyre vendore ose midis organeve të ndryshme vendore të administratës publike, kur ata e kërkojnë këtë zgjidhje.

Neni 4
Kufizime

Avokatura e Shtetit nuk mund të përfaqësojë dhe as të këshillojë për çështjet gjyqësore të një organi qendror të administratës publike kundër një organi vendor dhe anasjelltas, për çështjet gjyqësore të një organi qendror ose vendor të administratës publike kundër një organi tjetër qendror ose vendor, si dhe për çështjet gjyqësore midis administratës publike e punonjësve të saj, lidhur me marrëdhëniet e punës.

Neni 5
Detyrime të ndërsjella

1. Organet e administratës publike detyrohen t'i japin Avokaturës së Shtetit të gjitha sqarimet, informacionet dhe dokumentet e nevojshme që lidhen me procesin gjyqësor apo këshillimor.

Organet e administratës publike dhe entet publike në rast se paditen ose kanë vendosur të paditin, duhet të njoftojnë menjëherë, rezultatin e gjykimit në shkallë të parë, kur e kanë bërë vetë mbrojtjen dhe të kërkojnë këshillë për apelim, si dhe të konsultojnë kontratat me vlera të mëdha.

2. Avokatura e Shtetit e ushtron funksionin e saj në bashkëpunim me organet e administratës publike dhe entet publike. Avokatura e Shtetit mban parasysh udhëzimet e dhëna nga organi apo enti i interesuar, përveçse kur ato bien ndesh ne ligjin dhe me interesin publik.

Neni 6
Zgjidhja e konfliktit të opinioneve

Në rast konflikti opinionesh mbi ecurinë e procesit midis Avokaturës së Shtetit dhe organit të interesuar, është organi epror, sipas rastit organi i zgjedhur vendor, ministri përkatës apo Kryeministri, ai që vendos.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 7
Struktura

1. Avokatura e Shtetit varet nga Kryeministri, është organ i centralizuar dhe drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

2. Avokatura e Shtetit përbëhet nga Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, me seli në Tiranë dhe nga zyrat vendore që veprojnë pranë çdo gjykate të apelit, ku kanë edhe kompetencën tokësore.

3. Këshilli i Ministrave përcakton shtrirjen dhe numrin e përgjithshëm të zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit.

Neni 8

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit

1. Emërimi dhe shkarkimi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, bëhet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Kryeministrit.

2. Avokati i Përgjithshëm zëvendësohet, me porosi të tij, kur është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionin dhe me urdhër të Kryeministrit kur vendi mbetet i lirë, nga avokati më i vjetër në detyrë pranë Avokaturës së Përgjithshme.

3. Avokati i Përgjithshëm:

a) thërret dhe kryeson Këshillin e Avokaturës së Shtetit dhe Kolegjin e Avokatëve të Shtetit;

b) mbikëqyr të gjitha zyrat, shërbimet dhe personelin e Avokaturës së Shtetit dhe drejton organizimin e tyre;

c) u cakton çështjet gjyqësore, si dhe këshillimet avokatëve të shtetit, në shërbim pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit;

ç) miraton kërkesën e Avokatit për prefekturën për t'i ngarkuar vetë organit të interesuar mbrojtjen para gjykatës së shkallës së parë;

d) jep udhëzime të brendshme për trajtimin e çështjeve gjyqësore dhe të këshillimeve;

dh) i raporton periodikisht Kryeministrit për veprimtarinë e kryer nga Avokatura e Shtetit, duke theksuar mangësitë e mundshme ligjore dhe nevojat për ndryshime përkatëse;

e) paraqet një raport vjetor për Këshillin e Ministrave, lidhur me dëmin e shkaktuar nga organet e administratës publike ndaj interesave publike.

Neni 9

Këshilli i Avokaturës së Shtetit

1. Këshilli i Avokaturës së Shtetit (Këshilli) përbëhet nga Avokati i Përgjithshëm, Këshilltari Ligjor i Presidentit, Këshilltari Ligjor i Kryeministrit, përfaqësuesi i Prokurorit të Përgjithshëm, tre juristë të kualifikuar e me vjetërsi nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, një jurist i zgjedhur nga Shoqata e Kryetarëve të Bashkive dhe një jurist nga Shoqata e Kryetarëve të Komunave, si dhe pesë avokatë të shtetit, të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Avokatëve të Shtetit dhe sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren e Avokaturës së Shtetit. Këshilli ndihmohet teknikisht nga Sekretari i Përgjithshëm i Avokaturës së Shtetit.

2. Këshilli zgjidh mosmarrëveshjet sipas nenit 3 të këtij ligji.

Këshilli ushtron funksionet e komisionit disiplinor për Avokaturën e Shtetit.

Këshilli miraton rregullat e punës dhe vendos kritere për shpërndarjen e çështjeve; analizon rezultatet dhe vlerëson punën; jep mendim për qëndrimin përfundimtar të Avokaturës së shtetit në rastin e konfliktit të opinionëve midis kësaj dhe organit të interesuar, përfaqësues të të cilit ftohen të paraqesin pikëpamjen e tyre dhe ia përcjell këtë qëndrim organit epror, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Këshilli jep mendim dhe paraqet propozime për organizimin dhe plotësimin e shërbimeve; miraton kriteret për shpërndarjen e buxhetit sipas zërave të shpenzimeve ndërmjet zyrave të ndryshme të Avokaturës së Shtetit.

3. Aktet e Këshillit janë publike. Avokatët e shtetit vihen në dijeni dhe pajisen me kopje të tyre.

4. Këshilli mbledhet jo më pak se 1 herë në gjashtë muaj.

Neni 10

Kolegji i Avokatëve të Shtetit

1. Kolegji i Avokatëve të Shtetit (kolegji) përbëhet nga Avokati i Përgjithshëm i shtetit, i cili kryeson kolegjin, si dhe nga gjashtë avokatë të shtetit të zgjedhur për dy vjet nga Këshilli, tre prej të cilëve, së paku, nuk mund të jenë anëtarë të Këshilli.

2. Në kolegji marrin pjesë edhe deri në dy avokatë të shtetit, në varësi të çështjeve që trajtohen në atë mbledhje, si dhe mund të thirret të relatojë edhe avokati i shtetit i ngarkuar me çështjen që do të shqyrtohet.

Me kërkesën e Avokatit të Përgjithshëm, kur është e nevojshme, Kolegji mund të ftojë dhe përfaqësues të shtetit ose të enteve publike, që marrin pjesë pa të drejtë vote.

2. Kolegji thirret me rend dite të përcaktuar nga Avokati i Përgjithshëm, për t'u këshilluar për çështje shumë të rëndësishme ose të një rëndësie të veçantë, duke miratuar strategji të mbrojtjes për këto raste, si dhe për udhëzime të përgjithshme për bashkërendimin dhe trajtimin e çështjeve në proces dhe këshillimeve.

Kolegji gjithashtu zgjidh pasi ka dëgjuar të interesuarit, kundërshtitë e opinioneve që lindin në trajtimin e çështjeve gjyqësore në proces dhe këshillimeve, ndërmjet avokatëve që ushtrojnë funksione drejtuese dhe atyre që iu janë ngarkuar çështjet.

3. Vendimet e Kolegjit miratohen me shumicën e anëtarëve. Në rast barazie të votave, vota e kryetarit është vendimtare.

4. Procesverbali i mbledhjes së Kolegjit nënshkruhet nga Kryetari i Kolegjit dhe nga referuesi. Sekretari i Përgjithshëm i Avokaturës së Shtetit siguron mbështetjen teknike të mbledhjes së Kolegjit.

Neni 11

Avokatura e Përgjithshme e Shtetit

1. Përfaqësimi dhe mbrojtja e subjekteve, të përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, në procesin gjyqësor para Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së lartë, si dhe në gjykatat ndërkombëtare bëhet nga Avokatura e Përgjithshme e Shtetit.

2. Avokatura e Përgjithshme kryen edhe këto detyra:

- a) Administron të gjithë informacionin e siguruar nga zyrat vendore;
- b) Bashkërendon punët ndërmjet zyrave vendore, në zbatim të detyrave që burojnë nga ky ligj.
- c) Organizon takime këshilluese dhe seminare kualifikuese me juristë që punojnë në Avokaturën e Shtetit, si dhe në organet e administratës shtetërore.

Neni 12

Sekretari i Përgjithshëm i Avokaturës së Shtetit

1. Detyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Avokaturës së Shtetit i ngarkohet çdo tre vjet një avokati të shtetit, me urdhër të Kryeministrit, sipas propozimit të Avokatit të Përgjithshëm, bazuar në mendimin e dhënë nga Kolegji. Pas përfundimit të afatit 3-vjeçar, në rast të mosriemërimit në këtë funksion, personi kthehet në detyrën që ka pasur.

Në rast pamundësie reale ose juridike, Sekretari i Përgjithshëm zëvendësohet me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm me një avokat tjetër, i cili ngarkohet të ushtrojë përkohësisht funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm ndihmon Avokatin e Përgjithshëm me ushtrimin e funksioneve të tij, kujdeset për funksionimin e zyrave dhe të shërbimeve, dhe ushtron funksionet e shefit të personelit.

Neni 13

Zyra vendore e Avokaturës së Shtetit

1. Zyra vendore e Avokaturës së Shtetit, kryen këto detyra:

a) Përfaqëson organet e administratës publike dhe entet publike në gjykimet përpara gjykatave të shkallës së parë dhe asaj të apelit, të njësisë territoriale brenda së cilës ushtron juridiksionin e saj, si dhe në Gjykatën e Lartë, kur kjo i kërkohet nga Avokati i Përgjithshëm.

b) Kur nuk bën përfaqësimin, iu jep konsulencë juridike organeve të administratës publike dhe enteve publike të njësisë territoriale brenda së cilës ushtron juridiksionin e saj, për zgjidhjen e konflikteve para, gjatë dhe në përfundim të gjykimit të mosmarrëveshjeve, pranë gjykatave të përmendura në pikën "a" të këtij neni.

c) Bashkërendon punën për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për gjykim.

ç) Raporton në fund të çdo muaji në avokaturën e përgjithshme të shtetit në lidhje me numrin e çështjeve në proces gjykimi apo të përfunduara, si dhe për ecurinë e punës në përgjithësi.

d) Merr masa për caktimin e personave që do të përfaqësojnë shtetin në gjykimin e çështjeve konkrete.

2. Rastet e konfliktit të kompetencës territoriale midis zyrave vendore do të zgjidhen nga Avokati i Përgjithshëm.

3. Avokatët e shtetit mund të ngarkohen nga Avokati i Përgjithshëm të përfaqësojnë dhe të mbrojnë çështje që zhvillohen jashtë njësive territoriale që mbulon zyra e tyre.

Neni 14

Avokati i Shtetit pranë Gjykatës së Apelit

1. Avokati i shtetit pranë çdo gjykate të apelit caktohet nga Avokati i Përgjithshëm me pëlqimin e Këshillit.

2. Avokati i shtetit pranë çdo gjykatë të apelit:

a) ndjek dhe mbikëqyr, plotësimin e funksioneve të institucionit, organizimin dhe funksionimin e zyrës vendore;

b) u ngarkon avokatëve të avokaturës pranë gjykatës së apelit, çështjet në proces, në bazë të kriterëve të vendosura nga Kolegji;

c) drejton shqyrtimin kolegjial të çështjeve gjyqësore dhe këshillimeve të rëndësishme, informimin dhe bashkëpunimin e avokatëve të shtetit;

ç) përcakton drejtimit lidhur me trajtimin e çështjeve në proces;

d) i referon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit mbi veprimtarinë e zhvilluar nga avokatura pranë gjykatës së apelit, duke i vënë në dukje mosmarrëveshjet më të rëndësishme të shqyrtuara, mangësitë e akteve të administratës publike e në veçanti mangësitë ligjore dhe problemet e evidentuara në interpretimin e ligjeve;

dh) i referon organeve të pushtetit vendor dhe prefekturave për çështjet e shqyrtuara në interes të tyre, duke iu paraqitur dokumentacionin përkatës dhe duke iu vënë në dukje mosmarrëveshjet më të rëndësishme të shqyrtuara, si dhe mangësitë e akteve të tyre.

Neni 15

Avokati i Shtetit

1. Avokati i shtetit emërohet nga Avokati i Përgjithshëm sipas procedurave të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”.

2. Avokati i shtetit trajton çështjet gjyqësore dhe këshillimet që i ngarkohen.

3. Avokati i shtetit, në rast mospërputhje në mendim me avokatin e shtetit pranë gjykatës së apelit, mund t’i kërkojë me shkrim Avokatit të Përgjithshëm deklarin e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit dhe në rast se mbetet në kundërshtim me mendimin e tyre, i kërkon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit zëvendësimin për trajtimin e çështjes gjyqësore apo të këshillimit për të cilën ka lindur mospërputhja.

Avokati i shtetit zëvendësohet në trajtimin e çështjes së ngarkuar, në rast pamundësie reale ose juridike nga eprori i tij.

Avokati i shtetit mund të zëvendësohet në një çështje gjyqësore a këshillim nga avokati epror. Kundrejt kësaj mase mund të bëhet ankim në Këshillin e Avokaturës së Shtetit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për zëvendës.

Neni 16

Pajtimi i avokatëve në profesion të lirë

1. Në çështje të rëndësishme dhe kur natyra e çështjes kërkon juristë të specializuar në fusha të veçanta, Avokati i Përgjithshëm vetë ose me propozim të avokatit të shtetit pranë gjykatës së apelit për gjykimet deri në gjykatën e apelit, pajton avokatë në profesion të lirë.

Caktimi i avokatit në profesion të lirë, bëhet mbi bazën e aftësive të njohura profesionale të tij, kur plotëson kushtet e të qenit avokat i shtetit dhe kur nuk ka konflikt interesash me çështjen objekt gjykimi.

2. Kur çështja është objekt i shqyrtimit në një gjykatë të huaj, Avokati i Përgjithshëm, mund të pajtojë avokat një shtetas të huaj, me pëlqimin paraprak të Këshillit.

3. Avokati i pajtuar informon zyrën përkatëse mbi ecurinë e procesit në të gjithë fazat e tij.

4. Shpërblimi për avokatin në profesion të lirë përcaktohet në kontratë në bazë të praktikës së vendit, të vlerës së objektit të padisë, si dhe në varësi të përfundimit të çështjes.

5. Avokati i Përgjithshëm njofton herë pas here Këshillin për rastet e pajtimit të avokatëve të lirë, si dhe rezultatet e punës së tyre.

KREU III KUSHTET DHE DISIPLINIMI

Neni 17

Kushtet për të qenë avokat i shtetit

1. Avokati i shtetit mund të emërohet çdo shtetas që plotëson këto kushte:

a) të ketë përfunduar studimet e larta për Drejtësi;

b) të ketë një përvojë pune në praktikën gjyqësore dhe administrative për jo më pak se shtatë vjet;

c) të gëzojë reputacion nëpërmjet rekomandimeve të bashkësisë së juristëve;

ç) të mos jetë i dënuar penalisht apo i larguar për shkelje ose paaftësi nga shërbimi civil.

2. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit duhet të plotësojë kushtet për të qenë avokat i shtetit.

Neni 18

Papajtueshmëria

Avokati i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm, si dhe çdo avokat i shtetit nuk lejohet të kryejë funksione të tjera publike dhe private.

Neni 19

Konflikti i interesave

Avokati i Përgjithshëm, si dhe çdo avokat i shtetit nuk mund të përfaqësojnë shtetin në rast se kanë interesa, të njohura ose jo publikisht, lidhur me çështjen në gjykim, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 20

Shkarkimi i Avokatit të Shtetit

Avokati i shtetit mund të shkarkohet kur:

a) provohet se ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjake apo të personave me të cilët ka lidhje familjare;

b) provohet se me veprimet apo mosveprimet e tij ka krijuar favore për persona të tjerë, në dëm të interesave të shtetit;

c) nuk merr masa për sigurimin e ndjekjes gjyqësore të çështjeve, ku shteti është palë apo person i interesuar;

ç) kur kryen vepra penale.

Neni 21

Shpërblimi i posaçëm

Për çështje gjyqësore të vështira dhe me interes të madh ekonomik e financiar për Republikën e Shqipërisë, avokatit të shtetit i jepet shpërblim i posaçëm. Kriteret dhe procedurat caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 22
Sanksione

1. Kur detyrimi për njoftim, sipas nenit 5 të këtij ligji, nuk është bërë në kohë, Avokati i Përgjithshëm njofton eprorin e organit apo të entit publik që i përket ky detyrim.

2. Kur njoftimi, sipas nenit 5 të këtij ligji, nuk është bërë dhe nga ky veprim kanë ardhur pasoja, personi i cili ka qenë i ngarkuar për të bërë njoftimin përgjigjet sipas rregullave të përgjegjësisë civile. Në këto raste organi i administratës publike apo ai i entit publik ka të drejtë të ngrejë padi regresi në gjykatë.

KREU IV
TË FUNDIT

Neni 23

Këshilli i Ministrave, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, merr masat për ngritjen e institucionit të Avokaturës së Shtetit.

Këshilli i Ministrave miraton Rregulloren e Avokaturës së Shtetit.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2494, datë 6.12.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani